



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 15.6.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Daut Haradinaj, Etem Arifi, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar, përfaqësues të komunave Prishtinë, Podujevë, Mitrovicë, Shtërpçë si dhe nga Agjencia Kadastrale dhe ekspertët Skender Sina, Përparim Ahmeti dhe Arsim Avdijaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 6.6.2011,**
- 3. Dëgjimi publik lidhur me projektligjin për Kadastër,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.6.2011 nr. 10

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6.6.2011 pa vërejtje.

3. Dëgjimi publik rreth projektligjit për Kadastër

Kryetari Nait Hasani në fillim përshëndeti të pranishmit të cilët i falënderoj në pjesëmarrje dhe sqaroi arsyet e caktimit të dëgjimit publik nga grupi punues udhëhequr nga Liburn Aliu për të mbledhur sa më shumë fakte dhe sugjerime në mënyrë që në ditët në vijim të përfundoi me sukses shqyrtimi i projektligjit në fjalë. **Liburn Aliu** gjithashtu falënderoi duke prezantuar ekipin e grupit punues që punon në mbledhjen e fakteve relevante për të hartuar një ligj kualitativ. Ky grup punues, vazhdoi, do të punoi vazhdimisht në ditën në vijim duke pritur deri të premten (ora 11,00) vërejtjet me shkrim nga ata të cilët nuk i kanë dërguar deri tani, në mënyrë që të shqyrtohen ato të shtunën përkatësisht të dielën, nëse ka nevojë.

Përfaqësuesi nga Komuna e Kamenicës përshëndeti këtë takim por nuk kishte vërejtje me shkrim, ai apeloj për një ligj sa më përmbajtësor ngase siç tha në komunën e tyre ka lëndë që nuk janë zgjedhur që nga viti 1938.

Përfaqësuesi nga Komuna e Prishtinës parashtroi disa vërejtje me shkrim të cilat i sqaroi edhe gojarisht shkurtimisht (stafi do ti dorëzoj ato në grupin punues).

Përfaqësuesi nga Komuna e Podujevës lavdëroi modelin e hartuar të projektligjit duke parashtruar disa vërejtje më tepër teknike. Tek Neni 3 në pikën 1.16 ceket shkurtesa NSDI e cila duhet të sqarohet, pika 1.18 dhe 1.19 kanë disa gabime gjuhësore, tek Neni 4 nuk duhet të thuhet “në tekstin e mëtejshëm Agjencia” sepse nuk dihet cila Agjenci. Tek Neni 5 duhet të kemi parasysh çka nëse ndalohet puna e Gjeodetëve komunale.

Përfaqësuesi nga Komuna e Shtërpçës dhe Mitrovicës nuk kishin përgatitur vërejtjet me shkrim por falënderuan në bashkëpunim.

Përfaqësuesi i Shoqatës së Gjeodetëve privat të licencuar diskutoi lidhur me pengesat që i kanë në teren ngase gjeodetët e licencuar shumë pak kanë punë, ndaj apeloj që edhe në ligj të jepen më tepër të drejta të licencuarve me nivele. Ai kishte vërejtje tek Neni 29 si dhe propozoi të shtohet një Nen ku potencohet se punët e matjeve shtetërore janë në interes të Republikës së Kosovës. Ai tha se do të përgjigjet kërkesës së kryesuesit të GP që deri të premten me i dërgua vërejtjet me shkrim përmes stafit.

Hajzer Bublaku nga Agjencia Kadastrale u mundua të përmbledhë përgjigjet në diskutimet e dëguara duke theksuar qëllimin final të projektligjit. Në shumë komuna gjendja nuk është e kënaqshme, tha, si pasojë e asaj se këto punë i takojnë qendrës, si në sektorin privat ashtu edhe publik. Me këtë projektligj është tentuar të shkurtohen disa afate dhe të krijohet infrastruktura e të dhënave hapësinore për secilin vend, duke shfrytëzuar mundësinë e shfrytëzimit të kredisë nga Banka Botërore për interes të qytetarëve. Ai në vazhdim i komentoi vërejtjet nga përfaqësuesi i komunës së Prishtinës, duke cekur se disa referenca (emërtime) janë marr nga ligjet ekzistuese në fuqi p.sh. “ndërtesa”, “parcela ndërtimore” janë në kompetencën e MMPH etj ndërsa për “pjesën e ndërtesës” ishte i mendimit se duhet të jetë e veçantë, ngase edhe ajo mund të jetë objekt transaksioni. Nëse flitet për “bashkim” së pari duhet të krijohet bashkëpronësia e jo të kemi pronarë të ndryshëm. Në vazhdim ai komentoi edhe shprehjet “titulli absolut”, “shenjat e përkohshme”, “servitutet reale”, “mënyra të certifikimit” (për të cilat tha se agjencia i ka kryer trajnimet, mirëpo pastaj prapë ka vazhduar avazi i vjetër duke përdorur mjetet jo të sofistikuarat përkatësisht kompjuterizuara, agjencia nuk ka mundësi për trajnime të sërishme) etj. Sa i përket kuadrove ai pohoi se sektori privat qëndron larg nga ai publik me kualitet më të mirë, ngase sektori publik nuk stimulon. Kur të shihet nevoja, kjo çështje do të rregullohet me ligj.

Skender Sina parashtroi pyetje rreth objekteve nëntokësore të cilat patjetër duhet të evidentohen, për çka z. Bublaku tha se ka mjaft probleme me ato, të cilat tentohen të kryhen siç tha ai me “regjistrin me minuse”, mirëpo është e pamundur tha z. Sina ngase kryeqyteti p.sh. në zhvillimin e mëtejshëm do të ketë nevojë për nënkalime, pista etj të cilat evidentime duhet të vendosen në ligj e jo me minuse. Edhe përfaqësuesi i Prishtinës u pajtua me vërejtjet e z. Sina.

Përparim Ahmeti kërkoi nga përfaqësuesi i Prishtinës të paraqes me shkrim si mundën këto gjëra të rregullohen. **Arsim Avdijaj** pyeti përfaqësuesin e Agjencisë çfarë parashihet për matjet

kur dihet mirë qëndrimi ligjor (matjet i bëjnë ZKK). Hajzer Bublaku tha se matjet nga ZKK dhe matjet private nuk kanë dallim ngase zbatohen kriteret dhe standardet si në sektorin privat ashtu edhe publik.

Përfaqësuesi nga Komuna Gjilan nuk ishte prezentë por i ka dërguar vërejtjet me shkrim, të cilat gjithashtu do ti përcjellën grupit punues.

Nait Hasani përfundoi dëgjimin duke falënderuar dhe rikujtuar se vërejtjet mund të dërgohen deri të premtën.

4. Të ndryshme

Dëgjimi publik përfundoi në orën 12,50, ndërsa komisioni vazhdoi takimin në zyrën e Kryetarit ku u pajtua rreth tri emrave për ekspert rreth projektligjit për Verëra : Fejzullah Berisha, Selami Vuqiterna dhe Rrahman Kabashi të cilët deri më 22 qershor duhet ti dërgojnë CV-të në komision.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**
